





REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-4174/12</u>
Nr. I faq Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>15.11.2012</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	15.11.2012
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Miodrag Guzvic Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komuna e Parteshit
<b>CC:</b>	Nenad Cvetkovic Kryetari Komunës së Parteshit
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion për tenderin “Shërbimet të inxhinierisë për hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen gjatë realizimit”



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Shërbimet të inxhinierisë për hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen gjatë realizimit” me numër prokurimit 658 12 0132 21 ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, (në tekstin e mëtejshme AK), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik “Shërbimet të inxhinierisë për hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen gjatë realizimit”, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Komuna e Parteshit, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime" të procedurës së hapur me nr: prokurimit 658-12-013-221 me titull "Shërbime të inxhinierisë për hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen gjate realizimit", në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), neni 7.2 i Dosjes së tenderit ne faqe 16 tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar në pikën 5. Përgatitja profesionale e menaxherit të projekteve në fjale, dhe në pikën 7. lista e stafit punues (CV-në, diplomat dhe kontrata e punës) ku duhet të jenë kopje e vërtetuar nga notari. Ndërsa në pikën 8.1 te kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare është kërkuar minimum një referencë për projekte të realizuar të kësaj natyre.

Zyra e prokurimit në nenin 30.1 Kriteret për dhënie te kontratës, këto tri kërkesat e larte cekura i ka përsëritur edhe një here dhe poentuar sipas kriteri "tenderi i ekonomikisht me i favorshëm". Ndërsa kriterin vlere financiare e projekteve të realizuar në tri vitet e fundit të kësaj natyre është kriter i pamatshëm dhe në kundërshtim me nenet përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik. AK kriteret për tenderin ekonomikisht me të favorshëm nuk i ka vendosur ne Aneksin 6 te dosjes së tenderit ashtu siç kërkohet me dispozita përkatëse.

Me aktin e këtyllë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik, konkretisht këto dispozita:

- **Dispozitën e nenit 52 të LPP-së 03/L-042**

Në dosjen e tenderit "Shërbime" të procedurës së hapur, Pjesa II Përshkrimi i Çmimeve ne dy kolonat e fundit është kërkuar nga ofertuesit të paraqesin tenderët e tyre për: Çmimi në (€) për njësi i projektit kryesor (**zbatues**) me të gjitha fazat e nevojshme dhe Çmimi në (€) për njësi i **mbikëqyrjes** së projektit kryesor (**zbatues**).

Kështu që AK këto aktivitete të prokurimit duhet ti procedojë sipas KREUT IV Te Rregullave për Vlerësimin dhe Klasifikimin e Kontratave Publike dhe Konkurseve te Projektimit Ligjin nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit operativ për Prokurimi Publik. Njëherë AK duhet të specifikojë sasi të gjate përgatitjes se materialeve tenderuese përfshire publikimet, materialet tenderuese dhe kontratave sipas **Neni 26 i Rregullores për Prokurimi Publike**.

Me respekt!

